

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË SIPËRFAQEVE TË
GJELBRA PËR QSUNT”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): **77310000-6.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,781,084.61 (tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e njëmijë e tetëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 8 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së përllogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën

jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike. Garancia mbi përvojën e ngjashme është e rëndësishme, duke mbajtur në konsideratë natyrën e objektit e prokurimit, i cili vlerësohet nga AK se ka ndikim direkt jo vetëm në përmirësimin e shëndetit të pacientit por edhe tek stafi mjekësor e jomjekësor.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi inxhinier pyjesh/agrar/agronom,
- b) 8 (tetë) punonjës për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta
- c) 1 (një) shofer.

Për punonjësën në pikën a) duhet të paraqitet:

- diplomë përkatëse e arsimit të lartë, ku dëshmohet arsimit si inxhinier pyjesh/agrar/agronom;
- kontratë pune, të vlefshme

Për punonjësën në pikën b) duhet të paraqitet:

- kontratë pune, të vlefshme

Për shoferin duhet të paraqitet:

- kontratë pune, të vlefshme,
- Leje drejtimi për mjetin e kërkuar, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

Të dhënat për punonjësit e kërkuar që do të deklarohen, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, frekuencës së ekzekutimit të kontratës/ava, që do të lidhen dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Në tabelën e mësipërme është përcaktuar numri minimal i punonjësve, të cilët vlerësohen të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës, të cilat përfshin shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta, si më poshtë:

Përgjegjësi i shërbimit ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta, dhe të gjitha proceseve të punës, të përfshirë në këtë proces, duke mbajtur

përgjegjësi për zbatimin e objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Profili i kërkuar për përgjegjësin e shërbimit lidhet me natyrën e shërbimeve objekt prokurimi, duke siguruar një qasje profesionale dhe të mirëorganizuar në mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta. Kërkesa për profilet e kërkuara lidhet me faktin e njohurive që këta inxhinier kanë, lidhur me standartet dhe rregulloret mjedisore, për minimizimin e dëmit ndaj mjedisit, përmirësimin e biodiversitetit, diagnostikimin e sëmundjeve të bimëve dhe tokës duke marrë masat e duhura për trajtimin e tyre. Të gjitha këto njohuri të rëndësishme për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta, duke i bërë ekologjikisht të qëndrueshme, lidhen ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe sigurojnë AK për kryerjen e shërbimeve konform kërkesave të kërkuara.

Disponimi i punonjësve për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta siguron AK që ofertuesit zotërojnë personelin e nevojshëm për të kryer proceset, pjesë e këtij shërbimi si pastrimi me krehër bari, punim me bel, shkërim plisash, nivelim, furnizim dhe mbjellje fare bari, krasitje e gardheve, krasitje bari, plehërim, vaditje, spërkatje me insekticide, etj..

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në llojin dhe numrin e shërbimeve, frekuencat e kryerjes së tyre, ndarjen e territorit të QSUNT në gjashtë zona, si dhe nga vlerësimi i nevojave të AK, ku 6 punëtorë janë vlerësuar për kryerjen e shërbimeve për turnin e parë dhe 2 për turnin e dytë.

Shoferi është i nevojshëm për drejtimin e autobotit për vaditjen, shërbim i cili pëfshihet në objektin e prokurimit.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimalisht mjetet dhe pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- Autobot për vaditje 1 (një) copë
- Krasitëse ligustrash 2 (dy) copë
- Korrëse bari 2 (dy) copë
- Fije motokosë 1 (një) copë
- Motosharrë 1 (një) copë
- Gërshërë për krasitje 2 (dy) copë

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Për Autobotin: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Për mjetet dhe pajisjet e tjera, operatori ekonomik, duhet të paraqese dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta në ambientin spitalor të QSUNT.

Duke qenë se pjesë e shërbimeve është edhe vaditje me autobot, vlerësohet e nevojshme që ofertuesi të disponojë këtë mjet me qëllim përmbushjen e kërkesave të AK, të përshkruara në specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Disponimi i këtyre mjeteve dhe pajisjeve është vendosur bazuar në llojet e shërbimeve, pjesë e objektit të prokurimit, si: krasitje gardhesh, kositje bari, vaditje, duke shërbyer si garanci e AK që shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet konform të gjitha kërkesave të AK.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza””, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT